

PER GJYKATEN E APELIT PER KRIME TE RENDA TIRANE

64	83/18	83/18 perfituar me kontrate 2441 rep nr.kol 325 30.05.2009 sipërfaqe 450 m2, nga te cilat 200m2 truall dhe 80 m2 ndertese blere nga shitesi Petrit Hoxha.	4,369,210	
65		83/27 perfituar me kontrate rep 4271 nr.kol. 8579 31.07.2009 pemishta me sipërfaqe 138 m2, blere nga shitesit Ramazan, Ikbale, Elton Sijami dhe Elona Calliku.	42,642	
66		Te ardhura nga paga D. Gjoka viti Viti 2013		472,800
67		Te ardhura nga paga D. Gjoka viti Viti 2014		454,800
68		Te ardhura nga paga D. Gjoka viti Viti 2015		472,800
69		Kosto familjare viti 2013	102,288	
70		Kosto familjare viti 2014	102,288	
71		Kosto familjare viti 2015	102,288	
		SHUMA TOTALE	120,666,315	128,375,143

Ne total per shtetasin Dashamir Gjoka shpenzime blerje , investimet dhe shpenzimet te tjera te kryera 120,666,315 leke, burime financimi 128 375 143 leke. Teprice burime financimi ne vlere 7,708,828 leke.

Duke ju referuar të dhënave e bilanceve të shoqërisë në vite, të çertifikuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës si dhe raporti i kësaj drejtorie është arritur në përfundimin nga ekspertët, në total 01.01.2006 deri 31.12.2014, ku shoqëria është në pronësi të të paditurit Gjoka, si ortak i vetëm i shoqërisë, të ardhurat neto të shoqërisë janë:

- Kapitali i nënshkruar i mbartur në momentin e blerjes 3.900.000 lekë, rezervat ligjore 134.902 lekë, fitimi neto sipas tabelave të analizuarra më sipër rezulton të jetë 25.444.007 lekë. Mbi pyetjet e gjykatës ekspertët sqarojnë se këto fitime, mbasi pagohet TVSH-ja dhe devidenti, janë të lira të përdoren nga ortaku i vetëm i shoqërisë për shpenzime sikundër janë bërë.

Kërkimet e palës paditëse sipas objektit të padisë bazohen për rrjedhojë në akte ekspertimi kontabël të paqarta, të përgjithshme dhe që nuk i shërbejnë zgjidhjes së çështjes e për pasojë konkluzionet e bazuara në to përsa kohë janë të njëanshme dhe të pa ballafaquara me palët nw seancë gjyqësore duke ju shmangur kështu parimit të kontradiktorialitetit nuk mund të shërbejnë për zgjidhjen e çështjes.

Sa më sipër është rrjedhojë edhe e përfundimit të konkluzioneve të ekspertimit kontabël të kryer më 30 Nëntor 2014 nga eksperti Pashko ku dhe është bazuar kërkimi i palës paditëse në këtë proces, ku në përfundimet të tij shprehet se: *"Mendoj se në pamundësi të informacioneve më të sakta, ka vend për të rishikuar çdo gjë. Për të dhënë një përmbledhje të*